

VETËMJAFTIMI I LETËRSISË (OSE KUR LIRIA PRODHON VLERA SHPIRTËRORE)

Emin KABASHI

Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kosovë

Të gjitha ngjarjet e mëdha historike, sidomos luftërat për liri, qoftë në historinë e përbotshme, qoftë në historinë e popujve të caktuar, kanë lënë gjurmë të pashlyeshme edhe në krijimin e shenjave të mendësisë artistike në jetën e njerëzimit.

Mirëpo, ndodh që brenda ligjeve të caktuara të ketë edhe përjashtime. Në një pjesë të periudhës historike të popullit shqiptar, veçmas që nga gjysma e dytë e shekullit njëzet e kënde, koha kishte kaluar nëpër jetën e popullit pa lënë gjurmë, pa krijuar rrafshet shenjash të kujtesës historike dhe kombëtare, thuhet asgjë nuk kishte ndodhur në jetën historike të popullit shqiptar, thuhet çdo gjë ishte realizuar në jetën e tij historike dhe në jetën e tij brendshme dhe tashti shtrohet si një kërkesë, më shumë afinite krijuese, që të shpalohej anë dhe shtresime të jetës psikologjike sesa trajtimi i ngjarjeve që kishin hapur, apo kishin përmbysur procese të mëdha historike.

Në letërsinë shqipe mungon tërësisht, ose është trajtuar vetëm pjesë-

risht dhembja e madhe e stërkeqjes së epokës historike shqiptare, që ishte mbyllur me copëtimin e gjeografisë së tij kombëtare. Në letërsinë shqipe, mungon tërësisht, ose është trajtuar vetëm sa për të thënë, pjesa e jetës së brendshme të shqiptarëve në robëri, kudo që ka ndodhur, qoftë si pjesë, të degdisura jashtë kufijve të Shqipërisë londineze, qoftë brenda shtetit politik shqiptar. Në letërsinë shqipe mungon në tërësi trajtimi artistik i dhembjes së madhe të ndarjes, pra të copëtimit të gjeografisë kombëtare, sa njeriu shqiptar, pra lexuesi shqiptar krijon përshypjen se çdo gjë përherë ka qenë kështu, se çdo gjë që është krijuar kështu që kur dihet për perëndinë e kënde.

Kështu ka ndodhur edhe me ngjarjen më të madhe historike në jetën historike dhe në jetën e brendshme të popullit shqiptar, në fund të shekullit XX dhe në fillim të shekullit të ri. Pra, kështu ka ndodhur edhe me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Lufta e saj duke dhënë shenjat

e kujtesës historike, krijon rrafshin e mendësisë së krijimit të shenjave kombëtare. Janë një varg faktesh, shoqërore dhe historike, që flasin për rrafshin e krijimit të këtyre shenjave, që pasi janë trajtuar në disa shkrime, këtu nuk po i zë në gojë, me shpresë se ato do të bëjnë jetën e vetë në krijimin e mendësisë së përmasës historike dhe kombëtare të lexuesi shqiptar. Këtu, as që është vendi, as që ka nevojë të flitet për krijimin e kësaj mendësie të lexuesi i huaj.

Argumenti dhe mungesa e argumentit

Argumenti: Lufta e UÇK-së ka përmasë kombëtare nga fakti se përmbysi psikologjinë e robit për zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Mungesa e argumentit dhe dilema e parë: Por rrjedha e këtij procesi të madh historik që ka hapur lufta e UÇK-së, nuk ka gjetur as sot e kësaj dite trajtimin e duhur të letërsia e mirëfilltë artistike shqiptare.

Argumenti: Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, çështjen shqiptare e vuri në shkallë të zgjidhjes ndër-kombëtare si çështje të pazgjidhur, dhe kësaj ka krijuar mendësi të re, gjë që, edhe pse ishte krijuar në fund të shekullit XIX dhe në gjysmën e parë të shekullit XX, përveç ndonjë krijimi të rrallë artistik me peshë kombëtare, nuk kishte manifestuar shtrirjen e tra-

jtimit të ngjarjeve në përmasë kombëtare.

Mungesa e argumentit dhe dilema e dytë: Kjo ka ndodhur, ngase asnjëherë nuk është trajtuar artistikisht, pra nuk është krijuar vlerë e tillë artistike në letërsinë shqiptare, që do të mundësonte krijimin e rrafsheve të mendësisë kombëtare për tragjedinë e madhe të ndarjes. Për fat të keq nuk po shqyrtohet as sot.

Argumenti: Me këtë luftë kanë zënë të bien iluzionet për vetëmjaftimin e gjysmave, që është edhe një shtresë e psikologjisë së robit të shqiptarët, të andej dhe të këndej kufirit të Shqipërisë politike, të cilët as liria e krijuar pas Luftës së UÇK-së nuk i ka vetëdijësuar plotësisht për thellësinë e hendekut që ka krijuar ndarja shekullore e gjeografisë së tyre, ndarja e tërësisë së tyre kombëtare, e kulturës dhe e konkurrencës së mendimit shoqëror dhe politik shqiptar, si dhe të vlerave të tij artistike.

Mungesa e argumentit dhe dilema e tretë: Kur përmasa e tragjedive të këtilla nuk prodhon vlera të qëndrueshme, përveç të tjerash edhe artistike, atëherë në kulturat e popujve që kanë krijuar jetën e tyre të brendshme historike, konstatojnë se nuk është diçka në rregull me mendësinë shpirtërore të tyre. Letërsia shqiptare, sa di unë dhe sa kam informacion, nuk ka krijuar as këtë rrafsh të jetës së brendshme shqiptare.

Argumenti: Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përveç të tjerash, ka krijuar edhe shenjat e kujtesës historike, vendrëniet e dëshmorëve, si dhe vendpërjetësimet e tyre, siç janë varrezat e dëshmorëve apo lapidarët, shtatoret, obelisqet e kështu me radhë. Doemos pra, bashkë me këto shenja të jashtme janë krijuar edhe data historike, si shenja të një pjese të jetës së brendshme të një populli.

Mungesa e argumentit dhe dilema e katër: As gjithë varret e të rënëve në fushat e betejave, as varrezat masive të të viktimizuarëve, jo vetëm që nuk kanë gjetur rrugë për të krijuar rrafshje vlerash artistike në pjesën e letërsisë që krijohet në Kosovës (se krijime të aty-këtueshme ka pasur andej dhe këndej kufirit të Shqipërisë politike). Me këtë, mund ta kuptojmë argumentin e parë aq tragjik, se as varret e të rënëve për liri dhe tërësi kombëtare (nuk është aspak me rëndësi se çfarë thotë politika e ditës e shqiptarëve, në të dy anët e kufirit), as varrezat masive, as zhvendosja e popullatës, që është elementi i parë i zhbërjes së tërësive, ose pjesëve të gjeografisë kombëtare (pa marrë parasysh se në fjalorin e politikës shqiptare si trajtohen këto varreza masive e kjo zhvendosje e popullatës nga pjesë të gjeografisë së tij kombëtare), dëshmojnë se sa i rëndë, sa tragjik dhe sa pamundur është mbyllja e përnjëhershme e hendekut të ndarjes shekullore të shqiptarëve.

Argumenti: Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka kthyer në skenën e jetës historike të shqiptarëve Programin Kombëtar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Ngase që nga koha e Rilindjes Kombëtare, shqiptarët nuk kanë mendim politik kombëtar, andaj edhe janë iluzione ato që i shtrohen herë pas here në tryezën e mendimit politik, historik, shoqëror e shkencor opinionit të brendshëm dhe të jashtëm, se veprimë si një faktorë i bashkuar.

Mungesa e argumentit dhe dilema e pestë: Këtë anë të jetës së brendshme historike nuk ka arritur ta shpëtojë as folklori shqiptar, i mbetur ende gjallë, qoftë si relike e ndërgjegjësimit të vonshëm historik të shqiptarëve, qoftë si mbeturinë e organizimit socialist të masave të gjëra popullore.

Argumenti: Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka përmbytur përmasën e kohës së rrjedhës historike të shqiptarëve, ngase ka vënë në fillim të rrugës së zgjidhjes, çështjen e tyre të krijuar padrejtësisht nga faktorë shqiptarë dhe jashtë shqiptarë, sepse asnjë proces i madh historik, as nuk mbyllet e as nuk hapet vetëm nga pesha e faktorit të jashtëm. Andaj, formulimi se shqiptarët janë faktorë stabiliteti në rajon, është një formulim i politikës së ditës, ngase vetë fakti i nxjerrjes së çështjes shqiptare në përmasën që ka, dëshmon për anën e kundërt të këtij formulimi.

Mungesa e argumentit dhe dilema e gjashtë: Lufta e UÇK-së, duke krijuar shenjat historike, i mëson shqiptarët se iluzionet për lirinë që krijohet brenda një dite, bien ndesh me kërkesat që ajo të kultivohet vazhdimisht, sepse mungon edhe liria edhe rrafshet e kësaj mundësie historike, pra mekanizmat e shtetit, në mënyrë që ajo të bëhet mendësi kombëtare e shqiptarëve.

Derisa Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i zhbëri gjithë planet e fqinjëve dhe qendrave të vendosjes evropiane për mjaftueshmërinë e gjysmave të tërësisë së gjeografisë kombëtare të shqiptarëve, as mendimi politik, as ai shoqëror e shkencor, por as vlerat artistike të letërsisë shqiptare nuk krijuan rrafshet të kësaj mendësie.

Të gjitha këto kërkesa që vuri në skenën e zgjidhjes lufta në Kosovë, nuk bien ndesh me rrjedhën e ecjes botërore, as me përmasën historike të kësaj ecjeje, përkundrazi kjo ecje merr kuptim vetëm pasi të krijohet rrafshi i mendësisë se çështja shqiptare është një dhe kërkon vetëm një zgjidhje: natyrshmërinë e gjëllimit të popujve dhe të kombeve, andaj edhe të popullit dhe të kombit shqiptar. Krijimit të kërrij rrafshi, në radhë të parë i jep shpirt letërsia e një populli. Në këtë rast letërsia dhe kultura e popullit shqiptar, që ende mungon.

Bibliografi

1. Rexhep Qosja, *Strategjia e bashkimit shqiptar*, Tiranë, 1998.
2. Rexhep Qosja, *Paqja e përgjakshme-Konferenca ndërkombëtare për Kosovën, Rambuje 6-23.2.1999 - Paris 14-19.3.1999*, Tiranë, 1999.
3. Kudusi Lama, *Kosova dhe Ushtria Çlirimtare*, Tiranë, 2005.
4. Jakup Krasniqi, *Kthesa e madhe (Ushtria Çlirimtare e Kosovës)*, Prishtinë, 2006.
5. Ismail Kadare, *Ra ky mort dhe u pamë*, Tiranë, 1999.
6. Ismail Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, Tiranë, 2002.
7. Fitnete Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë - Pa apologji - Me fakte kundër shpifjeve*, Prishtinë, 2005.
8. Raymond Detrez, *Kosova lufta e shtyrë*, Tiranë, 2004.
9. Bardh Hamza, *Rrëfimi për luftën dhe lirinë (Dialog me Ramush Haradinajn)*, Prishtinë, 1999.
10. Bardh Hamza, *Paqja e gjeneralit (Dialog me Ramush Haradinajn)*, Prishtinë, 2001.
11. Hakif Bajrami, *Programi kombëtar politik i shqiptarëve*, Prishtinë, 2002.
12. Hakif Bajrami, *Si e okupoi Serbia Kosovën më 1912*, Prishtinë, 2003.
13. Grup autorësh, *Çështja e Kosovës problem historik dhe aktual*, Tiranë, 1996.
14. Grup autorësh, *Konferenca e Bujanit*, Tiranë, 1999.
15. Grup autorësh, *Pranverë e vonuar, (botim i Shoqatës atdhetare kulturore, "Kosova")*, Shkodër, 2000.

16. Bedri Tahiri, *Drenica-një shekull trimërie*, Prishtinë, 2001.
17. Halil Katana, *Tri dimensionet e Luftës Çlirimtare të Kosovës*, Tiranë, 2002.
18. Halil Katana, *Kudusi Lama, gjenerali i luftës*, Tiranë, 2002.
19. Dilaver Goxhaj (Shpëtim Golemi), *UÇK-ja dhe Kadareja*, Prishtinë, 2004.
20. Dilaver Goxhaj, *Rruga që më çoi në radhët e UÇK-së*, Tiranë, 2000.
21. Giuseppe Catapano, Nermin Vlora Falaschi, Skënder Riza, *Shqiptarët - popull i ndarë*, libri i parë, në dy gjuhë, shqip-anglisht, Pejë, 1996.
22. Arben Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e fuqive të mëdha 1912-1914*, Tiranë, 1978.
23. Fazli Veliu, *UÇK nga beteja në betejë-mesazhe të papërfunduara*, Tetovë, 2005.
24. Haki Braha, Enver Topalli, Astrit Bytyçi, *Njeriu i idealeve*, Ferizaj, 2002.
25. Ukë Thaçi, *Skenarët e masakrës*, Therandë, 2005.
26. Martin Çuni, *Reportazhe luftime*, Prishtinë, 2002.
27. Shaban Sinani, *Kosova në gjeopolitikë*, Tiranë, 1998.
28. Shaban Sinani, *Kosova në syrin e ciklonit*, Tiranë, 1999.
29. Shaban Sinani, *Mitologji në eposin e kreshnikëve*, Tiranë, 1998.
30. Ukshin Hoti, *Filozofia politike e çështjes shqiptare*, Prishtinë, 1997.
31. Janusz Bugajski, *Ngritja e Kosovës (artikuj dhe fjalime nga okupimi deri te pavarësia)*, Prishtinë, 2006.
32. Wesley K. Clark, *Të bësh luftë moderne*, Prishtinë, 2003.
33. Pettifer James, *Koncept për realitetin e ri - Dialog me Hashim Thaçin*, Prishtinë, 2001.
34. James Rubin, *Si e filluam luftën*, Tiranë, 2000.
35. Xhejms Rubin, *Një luftë shumë personale*, Tiranë, 2000.
36. Zyhdi Shehu, *Ushtar Kavaja*, Kavajë, 2000.
37. Emin Kabashi, *Robëria, iluzionet, shqiptarët*, Prishtinë, 1998.
38. Emin Kabashi, *Iluzionet, kultura, atdheu*, Prishtinë, 2005.
39. Emin Kabashi, *Nusja dhe lufta*, roman, Prishtinë, 1998.
40. Emin Kabashi, *Përmasa kombëtar e luftës së UÇK-së*, Prishtinë, 2005.
41. Emin Kabashi, *Batalioni "Atlantiku" i UÇK-së*, Prishtinë, 2004.
42. Emin Kabashi, *Shenjat e kujtesës historike (Lufta e UÇK-së në anën e Malishevës)*, Prishtinë, 2006.